



**RAPORTI VJETOR**  
**I**  
**INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË**  
**PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**  
**VITI 2018**

## TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE .....	3
<b>1. KUADRI LIGJOR DHE REFORMA NË DREJTËSI.....</b>	<b>5</b>
1.1 ZBATIMI I LIGJIT NR. 84/2016 “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQATARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE LIGJIT NR. 12/2018, DATË 5.3.2018 “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME” .....	5
1.2 ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE” .....	7
1.3 ZBATIMI I LIGJIT NR. 9049/2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR DHE SISTEMI ELEKTRONIK I DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË.....	11
<b>2 TË DHËNA MBI DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË.....</b>	<b>12</b>
2.1 ADMINISTRIMI I DEKLARATAVE .....	12
2.2 SKANIMI, PËRPUNIMI PARAPRAK DHE KONTROLLI ARITMETIK DHE LOGJIK.....	14
2.3 KONTROLLI I PLOTË.....	14
2.4 REZULTATET E KONTROLLIT.....	14
<b>3 ROLI PARANDALUES DHE NDËRGJEGJËSUES .....</b>	<b>16</b>
<b>4 BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR .....</b>	<b>18</b>
4.1 BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI I BRENDSHËM .....	18
4.2 BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË.....	19
<b>5 REKOMANDIMET E GRUPIT TË SHTETEVE KUNDËR KORRUPSIONIT..</b>	<b>21</b>
<b>6 TRANSPARENCA INSTITUCIONALE .....</b>	<b>22</b>
<b>7 PERFORMANCA FINANCIARE .....</b>	<b>23</b>
<b>8 PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE .....</b>	<b>25</b>
<b>9 PRIORITET PËR VITIN 2019 .....</b>	<b>27</b>
<b>ANEKSI NR. 1 .....</b>	<b>28</b>

## HYRJE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përgjatë vitit raportues, ka ushtruar kompetencat institucionale duke pasur në fokus të veçantë rekomandimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2018, në drejtim të ruajtjes dhe forcimit të pavarësisë dhe integritetit institucional, duke qenë kështu garant i paanshmërisë, transparencës dhe objektivitetit të institucionit, si faktorë që ndikojnë në rritjen e rezultateve konkrete në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Në këtë kuadër, Inspektori i Përgjithshëm, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 39, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar, në Raportin Vjetor të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave paraqet masat e ndërmarra për përmbushjen e prioriteteve dhe angazhimeve institucionale, në drejtim të forcimit të kapaciteteve në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është një dokument gjithëpërfshirës i punës dhe aktiviteteve institucionale; i problematikave dhe rezultateve të arritura në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi; masave konkrete të marra në funksion të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe të forcimit të shtetit ligjor, bashkëpunimit ndër-institucional e ndërkombëtar, si dhe të transparencës së realizuar me median, shoqërinë civile, organizmat ndërkombëtare dhe institucionet homologe.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*Inspektorati i Lartë*), gjatë vitit raportues, vijoi të mbështesë procesin reformues të sistemit të drejtësisë, si një masë e domosdoshme dhe emergjente për të rikthyer besimin e publikut tek institucionet e këtij sistemi, si dhe për të garantuar konsolidimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, me pjesën më të madhe të kapaciteteve të tij institucionale. Në këtë drejtim, bashkëpunimi ndër-institucional me organet e rivlerësimit kalimtar (vetting-ut) u konsolidua më tej, me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale në mënyrë sa më efektive, brenda afateve të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në fuqi, të lidhura me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kështu, Inspektorati i Lartë, në bashkëpunim të ngushtë me organet e rivlerësimit, përkatësisht me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), si dhe bazuar në listat e subjekteve të rivlerësimit dërguar nga këto organe dhe afatet e përcaktuara prej tyre, përfundoi verifikimin e të gjitha të dhënave të paraqitura në deklaratat e pasurisë nga subjektet e rivlerësimit, mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë së deklaruar, si dhe situatave të mundshme të konfliktit të interesave, brenda afateve ligjore.

Konkretisht, u përfundua dhe dorëzua pranë këtyre organeve, dokumentacioni i plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara, për gjyqtarët e gjykatave të apelit, Gjykatës së Apelit Administrativ, Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, si dhe prokurorët e prokurorive të apelit, Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda, ndihmësat dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative.

Për periudhën vijuese, Inspektorati i Lartë, do të vazhdojë procesin e dorëzimit të dosjeve dhe raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht të gjykatave dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para.

Në të njëjtën kohë, Inspektorati i Lartë, për periudhën e raportimit, ka vijuar me zbatimin me korrektësi të tre ligjeve bazë, respektivisht ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 60/2016 *“Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”*, duke pasur veçanërisht në fokus përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2018.

Në këtë drejtim, për t’u theksuar është angazhimi i gjerë institucional në rritjen e kapaciteteve të Autoriteteve Përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, si dhe njësisive përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016, si në sektorin publik dhe në atë privat. Gjatë vitit raportues, Autoritetet dhe Njësitë Përgjegjëse u përfshinë në një sërë sesionesh dhe aktiviteteve trajnuese/informuese për njohjen dhe zbatimin me përgjegjshmëri më të lartë të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave përsa i përket performancës institucionale gjatë vitit 2018, krahas paraqitjes në mënyrë të detajuar të raportit vjetor në vijim, të arritjeve dhe prioriteteve, dëshiron të ritheksojë angazhimin e tij në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese e ligjore lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve, forcimit të mëtejshëm të rolit institucional në kontrollin e deklarimit të interesave privatë, parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe hetimin e rasteve të sinjalizimit e garantimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.

## 1. KUADRI LIGJOR DHE REFORMA NË DREJTËSI

### 1.1 ZBATIMI I LIGJIT NR. 84/2016 “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE LIGJIT NR. 12/2018, DATË 5.3.2018 “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME”

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Inspektorati i Lartë), përgjatë vitit raportues, ka punuar në drejtim të përmbushjes së rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë të parashikuar në Rezolutën për vitin 2018 duke treguar *“Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit, duke garantuar me prioritet vijueshmërinë e zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting-un) në hartimin dhe dërgimin pranë institucioneve të rivlerësimit dhe ONM-së të dokumentacionit të plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara, sipas konkluzioneve të kërkuara nga neni 33 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë ka vijuar të ketë prioritet të punës së tij procesin e reformimit të sistemit gjyqësor, duke garantuar vazhdueshmërinë e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, si dhe këshilltarëve/ndihmësave ligjorë të të gjitha niveleve (Vetting), nëpërmjet angazhimit të pjesës më të madhe të kapaciteteve të tij institucionale.

Inspektorati i Lartë, përgjatë vitit raportues, vijoi procesin e përpunimit të të dhënave të ardhura nga korrespondenca e gjerë shkresore, e dërguar fillimisht nga rreth 26 institucione juridike publike dhe private, (Banka e Shqipërisë, banka të nivelit të dytë, shoqëri investimesh, ZQRPP, QKB, ALUIZNI, DPT, DPPPP, Drejtoria e Përgjithshme Detare, OSSHE, etj), por, që u shtua më tej, në varësi të ecurisë së procesit të kontrollit dhe nevojës për të marrë informacione shtesë pranë institucioneve juridike publike dhe private të tjera.

Në këtë kuadër, ILDKPKI në bashkëpunim të ngushtë me organet e rivlerësimit, Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) ka qenë tërësisht i angazhuar në përfundimin brenda afateve ligjore të proceseve të kontrollit të deklaratave të pasurive të subjekteve të rivlerësimit të përcaktuar në listat e dërguara prej tyre, sipas afateve të përcaktuara.

ILDKPKI, konkretisht ka përfunduar dhe dorëzuar pranë këtyre organeve, dokumentacionin e plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për gjyqtarët e gjykatave të apelit, Gjykatës së Apelit Administrativ, Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, si dhe prokurorët e prokurorive të apelit, Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda, ndihmësat dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative,

**për periudhën janar - dhjetor 2018, në total për 411 subjekte të procesit të rivlerësimit.** Ky numër, së bashku me subjektet e përfshira në listën prioritare, të dërguar pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës **nëntor - dhjetor 2017, shkon në total në 478 subjekte të procesit të rivlerësimit.**

Për sa më sipër, ILDKPKI mbetet e angazhuar për të vijuar procesin e dorëzimit të dosjeve dhe raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht të gjykatave dhe prokurorive të shkallëve të para, të Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para.

Inspektorati i Lartë shpreh angazhimin maksimal për të vijuar mbështetjen e procesit edhe përgjatë vitit 2019, në përmbushjen e detyrimeve të tij kushtetuese e ligjore në dorëzimin e raporteve përfundimtare, së bashku me dosjet respektive të subjekteve të rivlerësimit pranë organeve të rivlerësimit dhe ONM, sipas kërkesave periodike të paraqitura nga këto organe dhe të rakorduara me Inspektoratin e Lartë.

Për më tepër, në kuadër të proceseve reformuese, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 12/2018 "*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*", njohur dhe si Vettingu në Polici, në zbatim të nenit 9 pika 2 në të cilin parashikohet se "*...5 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit caktohen nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, të përzgjedhur ndërmjet punonjësve të këtij institucioni, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Ky organ cakton, gjithashtu, edhe 2 anëtarë zëvendësues, të cilët zëvendësojnë anëtarët që mungojnë..*" ka përzgjedhur dhe emëruar 5 Inspektorë pranë këtyre organeve. Inspektorët e ILDKPKI do të jenë tërësisht të angazhuar pranë organeve të vetting-ut për të dhënë ekspertizën dhe eksperiencën e tyre gjatë procesit të vlerësimit të subjekteve të parashikuar nga ligji, kryesisht në komponentin e vlerësimit të pasurisë.

Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë, me qëllim mbështetjen e procesit të vlerësimit kalimtar për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, përgjatë vitit raportues, mori të gjitha masat për të kryer procesin e kontrollit mbi deklaratat e interesave privatë për subjektet deklarues të parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, të cilët janë njëherazi dhe subjekte, që do t'i nënshtrohen kontrollit të parashikuar nga ligji nr. 12/2018. Kështu, Inspektorati i Lartë do të jetë në gjendje për të vënë në dispozicion deklaratat e interesave privatë, së bashku me materialet shoqëruese, të drejtuesve të nivelit të lartë të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës së Shqipërisë organeve të vetting-ut, që do të funksionojnë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, në varësi të kërkesave të tyre.

## 1.2 ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Inspektorati i Lartë), përgjatë vitit raportues, vijoi zbatimin e kompetencave të dhëna me anë të ligjit nr. 60, datë 2.6.2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, në kuadër dhe të përmbushjes së rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2018 “Zbatimin dhe monitorimin e ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në drejtim të forcimit të kapaciteteve të njësive përgjegjëse pranë organizatave të sektorit publik dhe privat, si dhe realizimin, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, të fushatave ndërgjegjësuese”.

Në zbatim të ligjit, ILDKPKI, përveç funksionimit si mekanizëm i jashtëm raportimi, ngarkohet: të monitorojë dhe të nxjerrë udhëzime për mekanizmat e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm; të kontrollojë funksionimin e duhur të mekanizmit të sinjalizimit të brendshëm të njësive përgjegjëse të organizatave; të konstatojë kundravajtjet administrative sipas këtij ligji dhe të vendosë gjoha në përputhje me nenin 23 të këtij ligji; të marrë dhe të hetojë kërkesat për mbrojtje ndaj masave hakmarrëse kundër sinjalizuesve dhe të garantojë mbrojtjen e sinjalizuesit nga masat hakmarrëse; mbi bazën e raporteve vjetore të njësive përgjegjëse, të hartojë vlerësime dhe të japë rekomandime për zbatimin e këtij ligji; të ofrojë këshillim dhe mbështetje në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve; të ndërgjegjësojë publikun për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, si dhe të rrisë pranimin kulturor të sinjalizimit.

Gjithashtu, ligji parashikon një sërë kundravajtjesh dhe masash administrative për shkelje të dispozitave të tij si; mosçaktimi i njësisë përgjegjëse nga organizata, marrja e çdo veprimi hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit; shkelja e parimeve të hetimit të sinjalizimit nga punonjësi; shkelja e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit; mosfillimi i hetimit ose përfundimi i hetimit administrativ nga punonjësi, duke parashikuar aplikimin e sanksioneve me gjobë, të cilat variojnë nga 100.000 deri në 500.000 lekë.

ILDKPKI, në përmbushje të detyrimeve ligjore, përgjatë vitit raportues mbajti kontakte të vazhdueshme me njësitë përgjegjëse në sektorin publik dhe privat, duke administruar dhe analizuar raportimet e dërguara prej tyre, si dhe duke bërë përditësimet e nevojshme në Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Autoritetet Publike dhe në Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në sektorin privat. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në total janë ngritur dhe funksionojnë **166 njësi përgjegjëse** në sektorin publik, si dhe **446 njësi përgjegjëse** në sektorin privat.

Në fokus të veçantë, përgjatë vitit raportues, ka qenë rritja e kapaciteteve të njësive përgjegjëse, si në sektorin publik dhe atë privat, ku me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë u arrit të realizoheshin një sërë aktiviteteve informuese dhe trajnuese.

Kështu, ILDKPKI me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”, projekt ndërmjet Austrisë, Gjermanisë dhe Shqipërisë, i financuar nga BE, në zbatim të parashikimeve lidhur me organizimin e sesioneve trajnuese për njësitë përgjegjëse pranë institucioneve publike, mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit, si dhe organizimin e një fushate ndërgjegjësuere për sektorin privat mbi zbatueshmërinë e ligjit, përgjatë vitit raportues, përfundoi procesin e rishikimit dhe finalizimit të kurrikulave trajnuese pranë ASPA-s. Në këtë kuadër, u përfundua hartimi i kalendarit të sesioneve trajnuese që do të zhvillohen në tremujorin e parë të vitit 2019, si dhe u identifikua trupa e trajnerëve, të cilët me mbështetjen e ekspertizës së ILDKPKI dhe ekspertëve të huaj, do të zhvillojnë një sërë sesionesh trajnuese për njësitë përgjegjëse pranë autoriteteve publike.

Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të Projektit të Binjakëzimit, gjatë muajit nëntor-dhjetor 2018, në bashkëpunim të ngushtë me nëpunësit e ILDKPKI dhe ekspertët e projektit, u arrit të finalizohet fletëpalosja e dedikuar për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, e cila i drejtohet publikut të gjerë, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre lidhur me këtë mekanizëm të ri në luftën kundër korrupsionit.

ILDKPKI, në bashkëpunim të ngushtë me OSBE, përgjatë vitit raportues, mori të gjitha masat për organizimin me sukses të disa sesioneve trajnuese për njësitë përgjegjëse në sektorin privat, të cilat synonin:

- Të rrisnin ndërgjegjësimin e njësive përgjegjëse për sinjalizimin lidhur me kuadrin ligjor në fuqi;
- Të trajnonin njësitë përgjegjëse për sinjalizimin mbi të drejtat, detyrimet e tyre lidhur me procesin e sinjalizimit, procedurat dhe politikat e brendshme për trajtimin e rasteve të sinjalizimit;
- Të paraqesnin praktikën më të mira ndërkombëtare lidhur me trajtimin e rasteve të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Në këtë kuadër, gjatë muajve tetor - nëntor 2018 u zhvilluan 12 sesione trajnuese, sipas një kalendarit të dakordësuar më parë midis Inspektoratit të Lartë dhe OSBE, me materialet e punuara nga eksperti i përzgjedhur nga OSBE, për **226 njësi përgjegjëse** të sektorit privat. Seminaret trajnuese u organizuan dhe u zhvilluan të ndara në 2 sesione:

- 1) Sesioni i parë, në të cilin u përfshinë disa nga konceptet bazë dhe kryesore të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve;
- 2) Sesioni i dytë, në të cilin u ndanë disa sugjerime konkrete me pjesëmarrësit mbi mënyrat e zbatimit të programeve mbi sinjalizimin/speak up apo anti-korrupsion.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të parashikimeve të neneve 13 dhe 22, të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, brenda datës 15 janar 2019 ka pritur dhe

administruar raportet vjetore të dërguara nga njësitë përgjegjëse, si nga autoritetet publike dhe organizatat private.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë ka marrë dhe administruar 157 raporte vjetore nga njësitë përgjegjëse pranë autoriteteve publike, ku nga analizimi i tyre konstatohet se në 3 njësi përgjegjëse janë sinjalizuar dhe trajtuar raste në kuadër të ligjit nr. 60/2016, si më poshtë vijon:

- 1- **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**, në të cilin janë paraqitur pranë njësisë përgjegjëse 3 raste sinjalizimi, lidhur me shpërdorim detyre nga ana e inspektorëve të sinjalizuar. Në përfundim të hetimit administrativ, janë referuar rastet pranë organeve disiplinore apo ligjzbatuese.
- 2- **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, në të cilin është regjistruar 1 rast sinjalizimi, për shpërdorim detyre, ku në përfundim të hetimit administrativ dhe auditimit të brendshëm është rekomanduar paraqitja e kallëzimeve penale për dy punonjës. Për njërin punonjës është marrë gjithashtu masë disiplinore me largim nga puna dhe zhdëmtim dëmi, ndërsa për punonjësit e tjerë janë marrë masa disiplinore vërejtje me shkrim.
- 3- **Autoriteti Portual Durrës** në të cilin është regjistruar 1 rast sinjalizimi.

Inspektorati i Lartë, në lidhje me njësitë përgjegjëse pranë sektorit privat ka marrë dhe ka administruar 247 raporte, ku nga analizimi i tyre konstatohet se nuk janë paraqitur raste sinjalizimi pranë këtyre njësive në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 60/2016.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë, gjatë vitit raportues, në ushtrim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, ka regjistruar dhe trajtuar në total **16 raste sinjalizimi dhe 3 raste kërkesë për mbrojtje të ardhur nga sektori publik.**

Nga rastet e sinjalizuara ka rezultuar sa më poshtë vijon:

- A) **në 6 raste** është pretenduar për shkelje gjatë ushtrimit të detyrës funksionale nga titullarët ose specialistët përkatës në autoritetin publik;
- B) **në 2 raste** është pretenduar për shkelje ligjore në procedurat e prokurimit;
- C) **në 6 raste** është pretenduar për shkelje në dhënien e vendimeve gjyqësore dhe falsifikim dokumentacioni në proceset gjyqësore;
- D) **në 2 raste** është pretenduar për situata të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

ILDKPKI ka marrë masa për të regjistruar të gjitha rastet e sinjalizuara në Regjistrin e Sinjalizimeve të Jashtme, si dhe për të zhvilluar hetimin administrativ në respektim të afateve ligjore në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 60/2016 dhe K.Pr. Administrative.

Në përfundim të hetimit administrativ, për zyrtarët e gjetur në shkelje të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, është marrë masa administrative “gjobë”, si dhe është kërkuar dhe është zgjidhur konflikti i interesit në përputhje me parashikimet ligjore.

Kështu, është aplikuar 1 (një) masë administrative “gjobë” ndaj një titullari institucioni për shkelje të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, si dhe janë zgjidhur të 2 (dy) rastet me konflikt interesi, me dorëheqje nga detyra të zyrtarëve që kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesave.

Gjithashtu, ILDKPKI për rastet e tjera të sinjalizuara, pas hetimit administrativ ka vënë në dijeni organin kompetent sipas problematikës së ngritur nga sinjalizuesit, si vijon:

- ✚ -Njoftim pranë KLSH për auditim të fondeve publike;
- ✚ -Njoftim për ndjekje penale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- ✚ -Njoftim Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- ✚ -Njoftim Titullarit të Autoritetit Publik Qendror, për marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Inspektorati i Lartë, lidhur me 3 kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, pas regjistrimit të tyre në Regjistrin e Kërkesës për Mbrojtje nga Hakmarrja, ka zhvilluar hetimin administrativ në përputhje me afatet ligjore të parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 60/2016 dhe K.Pr. Administrative. Në përfundim të hetimit administrativ, ka rezultuar se nuk kishte ndodhur asnjë akt hakmarrje të marrë nga organizata, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për sinjalizimin e jashtëm të paraqitur pranë ILDKPKI.

Inspektorati i Lartë, në një vlerësim të përgjithshëm mbi zbatimin e ligjit nr. 60/2016, duke marrë në konsideratë periudhën relativisht të shkurtër gjatë të cilës i ka shtrirë efektet juridike, si dhe qëllimin e tij për të trajtuar një fenomen të ri, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin e më gjerë, ku ende nuk ekzistojnë praktika të mirëfillta dhe të konsoliduara, thekson nevojën e kryerjes së një vlerësimi gjithëpërfshirës mbi këtë ligj, në mënyrë që të mund të debatohet mbi zbatueshmërinë apo efikasitetin e tij në të ardhmen.

ILDKPKI, vë në dukje se arritja e një niveli të kënaqshëm zbatueshmërie kërkon domosdoshmërisht rritjen e ndërgjegjësimit, jo vetëm të subjekteve të këtij ligji, por edhe të publikut të gjerë, si dhe vijimin e rritjes së kapaciteteve të njësive përgjegjëse, si në sektorin publik, po ashtu edhe në sektorin privat.

Gjithashtu, ILDKPKI shpreh nevojën për ndërhyrje në kuadrin ligjor lidhur me mekanizmat shtrëngues për plotësimin e kërkesave të nenit 22 të ligjit nr. 60/2016, pasi nga administrimi i raporteve vjetore, rezulton se nga sektori publik, kryesisht njësitë përgjegjëse në pushtetin vendor, si dhe nga sektori privat, raportet nuk dorëzohen brenda afatit ligjor të parashikuar. Në disa raste, këto raporte nuk janë dorëzuar edhe përtej afati ligjor.

Në të njëjtën kohë, ILDKPKI, në vitin në vijim, do të mbetet e angazhuar për të bashkëpunuar ngushtësisht me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar mbështetje institucionale në përmbushjen e nevojave të identifikuar, lidhur me mbulimin sa më të gjerë të njohjes dhe ndërgjegjësimit nga sektori publik dhe privat, të kuadrit ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

### 1.3 ZBATIMI I LIGJIT NR. 9049/2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR DHE SISTEMI ELEKTRONIK I DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË

ILDKPKI, në zbatim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2018, ku është theksuar vijueshmëria në “*Forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e formularëve të deklarimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës të Inspektoratit të Lartë, duke përfunduar ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit e publikimit të deklaratave të interesave privatë*”, përgjatë vitit raportues, ka vazhduar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në kuadër të projekteve asistuese në drejtim të ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit me University Research Co. (URC), me mbështetjen financiare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), për ofrimin e asistencës në përgatitjen dhe ngritjen e sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, për pjesën e programimit të sistemit (software), u angazhua në mbarëvajtjen e zbatimit të kontratës së nënshkruar në muajin shkurt 2018 midis kompanisë zbatuese të IT-së me qendër në Tiranë dhe USAID.

Në zbatim të këtij Memorandumi dhe Kontratës, gjatë muajve shkurt dhe mars të vitit 2018, aktivitetet e kompanisë zbatuese ishin të lidhura me fazën fillestare të projektit “EACIDS”, në drejtim të mbledhjes së informacionit mbi kërkesat funksionale dhe teknike, në identifikimin e roleve dhe përgjegjësisë, si dhe në kuptimin e proceseve kryesore të punës, me qëllim hartimin e dokumentit mbi studimin e kërkesave të sistemit dhe dokumenteve të dizajnit të tij.

Në vijim, dokumenti i studimit të kërkesave të sistemit, së bashku me dokumentin e dizajnit të sistemit, i është nënshtruar shqyrtimit, diskutimit dhe miratimit nga grupi teknik i punës, duke i hapur rrugën proceseve të mëtejshme zhvilluese. Përgjatë vitit raportues, janë përgatitur dhe dorëzuar pranë grupit teknik të punës 10 raporte progresi, të cilat paraqesin dhe evidentojnë ecurinë e zbatimit të projektit sipas planit të punës të parashikuar në Kontratë.

Kompania zbatuese e projektit, gjatë muajit dhjetor 2018, ka zhvilluar gjithashtu kurrikulat e trajnimeve për të gjitha modulet e sistemit elektronik të deklarimit të pasurive, si dhe ka organizuar fazën e parë të trajnimit për kategorinë e përdoruesve më kryesorë dhe të rëndësishëm të sistemit, pjesë e stafit të ILDKPKI. Sesionet e para trajnuese u zhvilluan për një periudhë 5 ditore, gjatë të cilave përdoruesit patën mundësinë të punojnë me sistemin e ri elektronik dhe të testojnë njohuritë e marra gjatë trajnimit. Faza e dytë e sesioneve trajnuese do të zhvillohet përgjatë vitit në vijim, duke pasur si grup të synuar, në përputhje me modulet e zhvillimit, të gjithë nëpunësit e ILDKPKI. Gjithashtu, synohet të organizohen sesione

trajnimi edhe për Autoritetet Përgjegjëse, si dhe sesione informuese për subjektet që mbartin detyrimin për deklarim.

Në të njëjtën kohë, Inspektorati i Lartë vijoi bashkëpunimin e ngushtë me Këshillin e Evropës për zbatimin e projektit “Veprimi kundër Krimin Ekonomik në Shqipëri” në kuadër të “Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” të bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, ku një nga komponentët e lidhur me sistemin online të deklarimit, sigurimi i pajisjeve (hardware), do të mbështetet nga ky projekt. Në këtë kuadër, gjatë periudhës shtator - tetor 2018, pas sigurimit të fondeve të nevojshme për të garantuar prokurimin e blerjes së të gjithë infrastrukturës hardware, nga ana e Këshillit të Evropës u realizua procedura përkatëse e prokurimit, duke u përzgjedhur dhe nënshkruar kontrata me kompaninë fituese. Në vijim të zbatimit të kontratës, Inspektorati i Lartë, koordinoi, së bashku me kompaninë fituese dhe Këshillin e Evropës, procesin e dorëzimit, instalimit, konfigurimit dhe pranimit të infrastrukturës hardware duke garantuar përfundimin e gjithë procesit përgjatë muajit dhjetor 2018.

Megjithë angazhimin e marrë nga ILDKPKI, së bashku me partnerët ndërkombëtarë, për të garantuar përfundimin e të gjitha fazave të nevojshme për ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit të deklarimit elektronik të interesave privatë, Inspektorati i Lartë mbetet i ndërgjegjshëm se, për zbatimin sa më efikas të këtij projekti, sfidë, vijon të mbetet jo vetëm bashkëpunimi ndërinstitucional për sigurimin e ndërlidhjes apo integritetit me sistemet e tjera publike/regjistrat publikë dhe privatë, me qëllim shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për kryerjen e kontrolleve dhe hetimeve administrative të deklaratave të interesave privatë, të cilat aktualisht janë procese që kryhen në mënyrë manuale, por edhe garantimi i një qëndrueshmërie të mtejshme të funksionimit të vetë sistemit.

Në këtë kuadër, ILDKPKI duke mbetur tërësisht e angazhuar për përfundimin e proceseve të lidhura me ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit të deklarimit elektronik të interesave privatë, thekson nevojën e sigurimit të mbështetjes nga institucione të tilla si Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, që do të mundësojnë garantimin e qëndrueshmërisë së këtij sistemi, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve financiare.

## **2 TË DHËNA MBI DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË**

### **2.1 ADMINISTRIMI I DEKLARATAVE**

Gjatë vitit 2018, Inspektorati i Lartë ka vijuar punën me procesin e pranimit, regjistrimit dhe administrimit të deklaratave të interesave privatë, të subjekteve që mbartin detyrim për deklarim. Nga të dhënat e regjistruara dhe të administruara nga Sektori i Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë, rezulton se numri i përgjithshëm i subjekteve (subjekte në funksion, ish-subjekte deklarues, kandidatë) deri më 31.12.2018 është **15.086 subjekte deklarues**, nga të cilët:

- **17.8 % ose 2.682 subjekte rezultojnë të jenë në funksion;**

- 82 % ose 12.373 subjekte rezultojnë të jenë ish-subjekte deklarues;
- 0,2 % ose 31 subjekte rezultojnë të jenë kandidatë.


Numri i deklaratave të administruara nga Inspektorati i Lartë për vitin 2018, është **3.679 deklarata të interesave privatë**, nga të cilat, të ndara sipas llojeve të tyre, rezultojnë këto të dhëna statistikore:

- Deklarata Periodike/Vjetore – **2.597 deklarata**;
- Deklarata Para Fillimit të Detyrës – **532 deklarata**;
- Deklarata Pas Largimit nga Funkzioni – **534 deklarata**;
- Deklarata Kandidati – **16 deklarata**.

Sikurse mund të vihet re edhe nga paraqitja grafike, 70.6 % e totalit të deklaratave të interesave privatë, të administruara nga ILDKPKI gjatë vitit 2018, përbëhet nga deklaratat Periodike/Vjetore, 14.4 % nga deklaratat Para Fillimit të Detyrës, 14.5% e tyre përbëhet nga deklarata Pas Largimit nga Funkzioni, si dhe 0.5 % e përbëjnë deklaratat e kandidatëve.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, tendenca në ulje e deklaratave të interesave privatë vjen si rrjedhojë e zbatimit të ndryshimeve ligjore që iu bëë kuadrit ligjor me anë të ligjit nr. 42, datë 6.4.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Në bazë të ndryshimeve, në nenin 3 “Subjektet që mbartin detyrimet për deklarimin”, u reduktua një kategori e ulët e subjekteve deklarues në sistemin e tatimeve, doganave dhe Policinë e Shtetit, si dhe një kategori e mesme në pushtetin vendor, deklaratat e të cilëve përbënin një numër të konsiderueshëm në totalin e deklaratave të administruara dhe kontrolluara nga ILDKPKI. Ky reduktim synoi, që detyrimi për deklarim të kryhet tashmë vetëm nga zyrtarët e nivelit më të lartë drejtues, duke çuar në rritjen e shpeshtësisë së kontrolleve për këtë nivel zyrtarësh.

### Deklarata të Interesave Privatë të Administruara Në 2018



## 2.2 SKANIMI, PËRPUNIMI PARAPRAK DHE KONTROLLI ARITMETIK DHE LOGJIK.

Inspektorati i Lartë, gjatë vitit raportues, ka administruar **3.679 deklaratat të interesave privatë**. Të gjitha deklaratat, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 24 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, i ndryshuar, që parashikon kalimin në fazën e skanimit, kontrollit të përpunimit paraprak, kryesisht lidhur me juridiksionin, rregullsinë e plotësimit të deklaratës, i janë nënshtruar këtij procesi, të përfunduar brenda vitit 2018. Për më tepër, Inspektorati i Lartë, njëkohësisht me procesin e skanimit dhe kontrollit paraprak, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 25 i ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ka kryer dhe procesin e kontrollit aritmetik dhe logjik, mbi saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar.

Në përfundim të procesit të kontrollit aritmetik e logjik, brenda datës 31.12.2018, janë kontrolluar të gjitha deklaratat e interesave privatë të administruara në vitin raportues, në total 3.679 deklaratat të interesave privatë.

## 2.3 KONTROLLI I PLOTË

Inspektorati i Lartë, gjatë vitit 2018, në zbatim të nenit 25/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, i ndryshuar, si dhe në përmbushje të objektit kryesor të veprimtarisë së tij, lidhur me ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të ardhurave e detyrimeve të deklaruar nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, ka miratuar dhe ka kaluar në kontroll të plotë në **total 780 subjekte deklarues**, si për shkak funksioni, ashtu edhe bazuar në informacione të ardhura nga denoncimet në numrin pa pagesë **0800 9999**, postën zyrtare dhe elektronike, median e shkruar, audio-vizive, etj.

## 2.4 REZULTATET E KONTROLLIT

Inspektorati i Lartë, krahas rolit parandalues, ka detyrimin ligjor të ushtrisë edhe kompetencat e tij ndëshkuese, përmes aplikimit të masave administrative, “gjobë”, propozimeve për masa disiplinore deri në largim nga detyra, drejtuar institucioneve publike, si dhe kallëzimeve/referimeve penale të depozituara pranë organit të akuzës, strukturave të hetimit tatimor, Policisë së Shtetit apo Drejtorisë së Prandalimit të Pastrimit të Parave, ndaj zyrtarëve-subjekte deklarues, të cilët janë gjetur në shkelje të ligjit.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë, në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave...*”, i ndryshuar dhe nenit 40, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, i ndryshuar, ka aplikuar masën administrative “gjobë”, për rastet e refuzimeve për deklarim, si dhe për rastet e mosdeklarimeve dhe/apo për çështje të konfliktit të interesave. Zyrtarët e ndëshkuar me masa administrative, “gjobë”, për periudhën deri më 31.12.2018 janë në **total 112 masa administrative**. ILDKPKI për periudhën 2014 – 2018 ka sanksionuar me masë administrative “gjobë” në total rreth **1.672 zyrtarë**.


Për t’u theksuar është fakti, se të gjitha masat administrative të vendosura nga Inspektorati i Lartë janë lënë në fuqi nga gjykatat administrative, me përjashtim të një numri të pakonsiderueshëm, për të cilat gjykata ka vendosur shfuqizimin ose ndryshimin e tyre.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës 2014 - 2018 ka referuar pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe Policisë së Shtetit **315 subjekte**, në të cilët janë përfshirë zyrtarë të të gjitha kategorive dhe niveleve, si Deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie, Drejtorë Drejtorie etj. Për periudhën raportuese janë paraqitur në **total 53 raste referimesh penale**.

Në një analizë krahasimore të rezultateve të kontrollit, të ndarë në dy periudha, ku periudha e parë përfshin vitet 2003 - 2013 dhe periudha e dytë përfshin vitet 2014 - 2018 është lehtësisht e evidentueshme rritja e performancës institucionale të Inspektoratit të Lartë, në mënyrë të konsiderueshme përgjatë pesë viteve të fundit.

Kështu, për periudhën gati 11 vjeçare 2003 – 2013, Inspektorati i Lartë rezultojn të ketë aplikuar në **total 118 masa administrative** dhe të ketë depozituar pranë organit të akuzës në total **57 kallëzime penale**; ndërsa vetëm për pesë vitet e fundit për periudhën 2014 – 2018, Inspektorati i Lartë rezultojn të ketë aplikuar në total **1.672 masa administrative** ndaj zyrtarëve, si dhe të ketë aplikuar **140 masa administrative** me “gjobë” në kuadër të ligjit nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”. Në total për periudhën 2014-2018 rezultojn të jenë aplikuar **1.812 masa administrative "gjobë"**. Gjithashtu, rezultojn të ketë referuar pranë Institucionit të Prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit, si dhe strukturave të hetimit tatimor në total **315 kallëzime penale dhe referime të tjera**.

Inspektorati i Lartë ka arritur jo vetëm të tejkalojë në mënyrë të dukshme aplikimin e masave administrative të zbatuara ndaj subjekteve deklarues të gjetur në shkelje të detyrimit për të deklaruar pasurinë dhe për të shmangur konfliktin e interesit në krahasim me periudhën e mëparshme prej 11 vitesh, por mbi të gjitha ka rritur me më shumë se 5-fish numrin e kallëzimeve penale për zyrtarë, të cilët kanë rezultuar në fshehje ose deklarim të rremë të pasurisë së tyre.



Në këtë mënyrë dhe nëpërmjet rezultateve të arritura, Inspektorati i Lartë ka siguruar zbatimin e rekomandimit, të përcaktuar në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për vitin 2018, e cila kërkonte nga ILDKPKI *“Ndjekjen dhe zbatimin e skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklaruese, në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar”.*

### 3 ROLI PARANDALUES DHE NDËRGJEGJËSUES

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave gjatë vitit raportues i ka kushtuar një vëmendje të veçantë rolit të tij ndërgjegjësues dhe parandalues, në funksion të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive...”*, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave...”*, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 60/20162016 *“Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”*. Ky rol është ushtruar duke përdorur të gjitha mjetet ligjore dhe institucionale në dispozicion të institucionit, duke arritur në organizimin e një sërë sesionesh trajnuese e informuese për Autoritetet Përgjegjëse, njësitë përgjegjëse, deputetë të Kuvendit dhe zyrtarë të lartë të administratës publike.

Inspektorati i Lartë, përgjatë vitit raportues, në vijim të zbatimit të Projektit të Binjakëzimit *“Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”*, ku një nga komponentët e tij i është dedikuar ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, së bashku me ekspertët e projektit, ekspertët vendas, si dhe në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), gjatë periudhës maj - qershor 2018, organizoi dhe zhvilloi disa sesione trajnuese për Autoritetet Përgjegjëse në nivel qendror, lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të parashikuara nga ligji për parandalimin e konfliktit të interesave privatë. Gjatë këtyre sesioneve morën pjesë dhe u trajnuan rreth 252 pjesëmarrës nga Autoritet Përgjegjëse.

Në vijim, gjatë muajit dhjetor 2018, u organizuan dhe u zhvilluan sesionet trajnuese për Autoritetet Përgjegjëse në nivel vendor, ku morën pjesë dhe u trajnuan rreth 100 pjesëmarrës. Si rrjedhojë e këtyre aktiviteteve, gjatë periudhës së raportimit, në total janë trajnuar rreth 352 pjesëmarrës nga Autoritetet Përgjegjëse.

Gjithashtu, ILDKPKI në përmbushje të rekomandimit të Kuvendit në Rezolutën e vitit 2018 në të cilin parashikohet se *“Kuvendi dhe ILDKPKI të bashkëpunojnë gjatë vitit 2018 për zbatimin e duhur të Kodit të Sjelljes së Deputetëve, të miratuar më vendim të Kuvendit nr. 61/2018, duke siguruar këshillim, trajnim dhe udhëzime lidhur me mënyrat e trajtimit të konfliktit të interesit të deputetëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues”*, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e projektit të binjakëzimit, ekspertët vendas dhe Kuvendin, organizoi një Simpozium mbi Konfliktin e Interesit, ku u ftuan të merrnin pjesë të gjithë deputetët. Në vijim të këtij aktiviteti, Inspektorati i Lartë me burimet e tij institucionale

dhe në bashkëpunim të ngushtë me administratën e Kuvendit, gjatë muajit nëntor 2018 zhvilloi sesion trajnues tre-ditor për deputetët, ku u trajtuan çështje të konfliktit të interesit, identifikimi, trajtimi dhe zgjidhja e tyre, si dhe trajtimi i konfliktit të interesit në kontekstin e zbatimit të Kodit të Sjelljes së Deputetëve.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë mori të gjitha masat e nevojshme institucionale dhe koordinuese, së bashku me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit dhe partnerët vendas, për organizimin e Forumit Konsultativ me zyrtarët e lartë të administratës shtetërore, me temë “*Konflikti i Interesit*”, i cili u zhvillua më datë 7 nëntor 2018.

ILDKPKI, gjatë vitit raportues, ka qenë i angazhuar edhe lidhur me rritjen e kapaciteteve të njëjësive përgjegjëse pranë autoriteteve publike dhe private të ngarkuara për zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, duke ju dhënë në mënyrë të vazhdueshme asistencë për çështje të parashtruara lidhur me njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor, si dhe ofrimin e sesioneve trajnuese.

Në këtë kuadër, ILDKPKI, me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “*Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit*”, në përputhje me parashikimet lidhur me organizimin e sesioneve trajnuese për njësitë përgjegjëse pranë institucioneve publike mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit, si dhe organizimin e një fushate ndërgjegjësuese për sektorin privat mbi zbatueshmërinë e ligjit, përgjatë vitit raportues, përfundoi procesin e rishikimit dhe finalizimit të kurrikulave trajnuese pranë ASPA. Në këtë kuadër, u përfundua hartimi i kalendarit të sesioneve trajnuese, që do të zhvillohen përgjatë vitit në vijim, si dhe u identifikua trupa e trajnerëve, të cilët me mbështetjen e ekspertizës së ILDKPKI dhe ekspertëve të huaj, do të zhvillojnë një sërë sesionesh trajnuese për njësitë përgjegjëse pranë autoriteteve publike.

Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të Projektit të Binjakëzimit, gjatë muajit nëntor-dhjetor 2018, në bashkëpunim të ngushtë me nëpunësit e ILDKPKI dhe ekspertët e projektit, u arrit të finalizohet fletëpalosja e dedikuar për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, e cila i drejtohet publikut të gjerë me qëllim ndërgjegjësimin e tyre lidhur me këtë mekanizëm të ri në luftën kundër korrupsionit.

Për më tepër, ILDKPKI në bashkëpunim të ngushtë me OSBE përgjatë vitit raportues, mori të gjitha masat për organizimin me sukses të 12 sesioneve trajnuese për njësitë përgjegjëse në sektorin privat, gjatë të cilave u arrit të trajnoheshin 226 njësi përgjegjëse pranë këtij sektori.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë, në zbatim të detyrimeve të tij ligjore, në mënyrë periodike, por dhe rast pas rasti në bazë kërkesash, ka ofruar asistencë teknike dhe ligjore për Autoritetet Përgjegjëse, si strukturat kryesore për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave brenda institucionit, ku ato ushtrojnë funksionet e tyre.

Duke qenë se Autoritetet Përgjegjëse janë ato që evidentojnë, administrojnë dhe trajtojnë konfliktin e interesave rast për rast, çdo herë, kur institucionet publike i janë drejtuar zyrtarisht

Inspektoratit të Lartë, duke i kërkuar asistencë ligjore për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesave, Inspektorati i Lartë është përgjigjur duke organizuar takime të veçanta sqaruese me zyrtarë të niveleve të ndryshme brenda të njëjtit institucion mbi problematikat institucionale apo individuale të ndeshura.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë në përmbushje të detyrimit ligjor, të parashikuar nga neni 42 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka administruar brenda afatit ligjor, raportet e dërguara nga çdo Autoritet Përgjegjës lidhur me veprimtarinë e kryer prej tyre në zbatim të ligjit, përfshirë edhe rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarin periodik të interesave privatë.

#### **4 BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR**

##### **4.1 BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI I BRENDSHËM**

Inspektorati i Lartë, duke e vlerësuar bashkëpunimin ndër-institucional me organet ligjzbatuese, si një element të domosdoshëm në drejtim të garantimit të sigurisë dhe efektivitetit të kontroleve dhe hetimeve administrative, ka vijuar përgjatë vitit raportues zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet kryesore në identifikimin dhe luftën kundër korrupsionit, parandalimit të pastrimit të parave dhe krimin të organizuar, konkretisht me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve/Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Në këtë kuadër, gjatë vitit raportues, ILDKPKI, më datë 26.10.2018, ka rinovuar marrëveshjen e bashkëpunimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit, duke synuar forcimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet palëve, për shkëmbimin e informacioneve për subjektet që mbartin detyrimin për deklarin të interesave privatë në ILDKPKI, me qëllim evidentimin e saktë të rasteve të konfliktit të interesave gjatë procedurave të prokurimeve publike dhe nënshkrimit, zbatimit të kontratave administrative, rritjen e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndër-institucional në luftën kundër veprave penale në fushën e krimin ekonomik dhe korrupsionit, si dhe koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta për hetimin administrativ dhe referimeve pranë strukturave përgjegjëse për hetimin penal të subjekteve që mbartin detyrim për deklarin të interesave privatë.

Gjithashtu, përgjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë ka intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit në kuadër të marrjes së informacioneve nga institucionet publike dhe private, në kuadër të verifikimit të të dhënave të pasqyruara nga subjektet e përfshira në procesin e rivlerësimit kalimtar (vettingut) në sistemin e drejtësisë, por edhe në radhët e Policisë së Shtetit e Gardën e Republikës së Shqipërisë. Korrespondenca shkresore përfshiu fillimisht përreth 26 institucione publike dhe private, (Banka e Shqipërisë, banka të nivelit të dytë, shoqëri investimesh, ZQRPP, QKB, ALUIZNI, DPT, DPPPP, Drejtoria e Përgjithshme Detare, OSHEE, etj.), duke vijuar më tej shtimin e saj në varësi të ecurisë së procesit të kontrollit dhe nevojës për të marrë informacion shtesë.

Inspektorati i Lartë, përtej përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, ka vazhduar të japë në mënyrë periodike/mujore arritjet dhe sfidat institucionale të tij, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të Bashkimit Evropian (BE) për Prioritetin 2 “Të sistemit të drejtësisë” dhe Prioritetin 3 “Të luftës kundër korrupsionit”, për aderimin e Shqipërisë në BE, duke ju përgjigjur në kohë institucioneve të tjera shtetërore të përfshira në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, si Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Ministrinë e Drejtësisë.

#### 4.2 BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

ILDKPKI, përgjatë vitit raportues, ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, me Agjencitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si USAID, Këshillin e Evropës, zyrën e OSBE-së në Tiranë, si dhe ka pasur në fokus të punës, forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve institucionale dhe shtimin e kontakteve me zyrat homologe apo agjencitë antikorrupsion në rajon dhe më gjerë.

Në këtë kuadër, ILDKPKI në bashkëpunim me Agjencinë Italiane të Antikorrupsionit me mbështetjen e TAIEK, në datat 11 - 12 janar 2018, organizoi një Seminar Rajonal mbi “Transparencën dhe Prokurimin Publik”, ku morrën pjesë përfaqësues të institucioneve dhe agjencive rajonale të përfshira në luftën kundër korrupsionit, transparencës, si dhe prokurimit publik, përkatësisht të Shqipërisë, Italisë, Kroacisë, Kosovës, Malit të Zi, Serbisë, Rumanisë.

Seminari ishte i fokusuar në trajtimin e çështjeve të transparencës, si një instrument për parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e efektivitetit të veprimeve të administratës publike, si dhe trajtimin e kuadrit ligjor lidhur me prokurimet publike në vendet e rajonit të krahasuar me të drejtën europiane të zbatueshme në këtë fushë.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë ka qenë i angazhuar me pjesëmarrjen në takime, tryeza të rrumbullakëta, konferenca dhe seminare lidhur me çështje që lidhen me luftën kundër korrupsionit. Konkretisht, përfaqësues të ILDKPKI morrën pjesë në Konferencën Rajonale Kundër Korrupsionit të organizuar në Prishtinë më 4 - 5 tetor 2018 nga Agjencia Kundër Korrupsionit të Kosovës, si dhe në datat 13 - 14 dhjetor 2018, Inspektorati i Lartë u përfaqësua në Konferencën Ndërkombëtare me temë “Zbatimi i Mekanizmave të Parandalimit të Korrupsionit”, të organizuar në Beograd nga Agjencia Kundër Korrupsionit e Serbisë, me mbështetjen e OSBE/Zyra në Serbi dhe Ambasada e Republikës së Italisë në Serbi.

Për më tepër, ILDKPKI, gjatë vitit 2018, vijoi procesin e zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”, projekt ndërmjet Austrisë, Gjermanisë dhe Shqipërisë, i financuar nga BE.

Inspektorati i Lartë, si përfitues me tre komponentë kryesorë të tij, lidhur me komponentin për rritjen e kapaciteteve të institucionit, bashkëpunoi me ekspertët e projektit, si dhe ekspertët e Këshillit të Evropës për organizimin në datat 26 - 27 prill 2018, të sesionit trajnues “Deklarimi dhe kontrolli i pasurive të personave të zgjedhur dhe të disa nëpunësve publikë”.

Në këtë trajnim ishin të pranishëm të gjithë nëpunësit me funksion Inspektor dhe Ndihmës/Inspektor, të cilët patën mundësinë për t'u njohur dhe diskutuar mbi praktikën e ndryshme të vendeve të BE-së lidhur me metodat e kontrollit të pasurive, si dhe mbi mënyrat e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave më të mira ekzistuese mbi deklarimin e pasurive.

Në lidhje me komponentin që ka në fokus ligjin e parandalimit të konfliktit të interesave, gjatë vitit raportues, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e projektit, ekspertët vendas dhe ASPA u finalizua rishikimi i kurrikulës mbi parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe u zhvillua një trajnim trajnerësh, të cilët u angazhuan në zhvillimin e sesioneve trajnuese për Autoritetet Përgjegjëse. Në këtë kuadër, gjatë muajve maj - qershor 2018, si dhe në muajin dhjetor 2018 u zhvilluan trajnimet për Autoritetet Përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, ku 352 pjesëmarrës nga Autoritet Përgjegjëse morrën njohuri lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të parashikuara nga ligji për parandalimin e konfliktit të interesave privatë.

Për më tepër, në përmbushje të aktiviteteve të parashikuara në këtë komponent, si dhe në zbatim të rekomandimit të Kuvendit në Rezolutën e vitit 2018 në të cilin parashikohet se *“Kuvendi dhe ILDKPKI të bashkëpunojnë gjatë vitit 2018 për zbatimin e duhur të Kodit të Sjelljes së Deputetëve, të miratuar më vendim të Kuvendit nr. 61/2018, duke siguruar këshillim, trajnim dhe udhëzime lidhur me mënyrat e trajtimit të konfliktit të interesave të deputetëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues”*, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e projektit të binjakëzimit, ekspertët vendas dhe Kuvendin, organizoi një Simpozium mbi Konfliktin e Interesit, ku u ftuan të merrnin pjesë të gjithë deputetët. Për t'u theksuar, është dhe organizimi i Forumit Konsultativ mbi parandalimin e konfliktit të interesave me zyrtarë të lartë të administratës shtetërore, i organizuar në bashkëpunim me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit dhe partnerët vendas.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë në vijim të zbatimit të komponentit lidhur me ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, gjatë vitit raportues, finalizoi aktivitetin lidhur me rishikimin e kurrikulës për organizimin e trajnimit të Autoriteteve Përgjegjëse pranë institucioneve publike mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit, si dhe fushatës ndërgjegjësuese për sektorin publik dhe atë privat. Në këtë kuadër, u përfundua hartimi i kalendarit të sesioneve trajnuese, që do të zhvillohen përgjatë vitit në vijim, si dhe u identifikua trupa e trajnerëve, të cilët me mbështetjen e ekspertizës së ILDKPKI dhe ekspertëve të huaj, do të zhvillojnë një sërë sesionesh trajnuese për njësitë përgjegjëse pranë autoriteteve publike. Gjatë muajit nëntor - dhjetor 2018, në bashkëpunim të ngushtë me nëpunësit e ILDKPKI dhe ekspertët e projektit, u arrit të finalizohet fletëpalosja e dedikuar për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, e cila i drejtohet publikut të gjerë me qëllim ndërgjegjësimin e tyre lidhur me këtë mekanizëm të ri në luftën kundër korrupsionit.

Në drejtim të rritjes së kapaciteteve të njësive përgjegjëse pranë sektorit privat, gjatë vitit raportues, bashkëpunimi me OSBE ka qenë i sukseshëm në realizimin e 12 sesioneve

trajnuese për njësitë përgjegjëse në sektorin privat, gjatë të cilave u trajnuan 226 njësi përgjegjëse pranë këtij sektori.

Për më tepër, ILDKPKI, gjatë vitit 2018, ka koordinuar procesin e bashkëpunimit midis projekteve të Këshillit të Evropës dhe USAID, për ofrimin e asistencës teknike dhe financiare në ngritjen e sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, në zbatim edhe të rekomandimit të Kuvendit në Rezolutën për vitin 2018, ku është theksuar vijueshmëria në *“Forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e formularëve të deklarimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës së Inspektoratit të Lartë, duke përfunduar ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit e publikimit të deklaratave të interesave privatë”*.

Për sa më sipër, mbështetja operationale e partnerëve ndërkombëtarë apo me ekspertë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, ka qenë e vlefshme dhe e mirëpritur nga Inspektorati i Lartë, ndaj i falenderojmë publikisht për ndihmesën e tyre.

## 5 REKOMANDIMET E GRUPIT TË SHITETEVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës raportuese, ka vijuar aktivitetin institucional duke pasur në fokus edhe rekomandimet drejtuar Republikës së Shqipërisë nga GRECO, në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë që trajton *“Parandalimin e korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët”*, si dhe në Raportin për Vlerësimin e Përputhshmërisë për Shqipërinë.

Në këtë kuadër, në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të miratuar në Mbledhjen Plenare të 80-të, të mbajtur më 18 - 22 qershor 2018, GRECO vlerësoi si të përmbushur të dy rekomandimet që kishin të bënin, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, me punën dhe veprimtarinë e ILDKPKI.


Konkretisht, në lidhje me Rekomandimin iv.) *Bërja publike e përmbajtjes së deklaratave të pasurive të deputetëve në faqen e internetit në kohën e duhur, duke i kushtuar rëndësi privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe të personave të lidhur me ta, që janë objekt i detyrimit për raportim*, GRECO mirëpriti punën që po ndërmerret për të përmirësuar deklaratimet e aseteve dhe sistemin e kontrollit në mënyrë që deklaratat e interesave privatë të bëhen online dhe të përpunohen në mënyrë elektronike, duke siguruar kështu efektivitetin e sistemit të kontrollit dhe duke lejuar deklaratat e pasurisë të publikohen në faqen e internetit të ILDKPKI. Gjithashtu, GRECO, në mbështetje të të dhënave mbi përpunimin dhe publikimin e deklaratave të interesave privatë, kryesisht të deputetëve, vlerësoi se deklaratat e pasurive të deputetëve tashmë janë bërë publike në një faqe zyrtare, duke arritur në përfundimin se **rekomandimi iv** është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Në vlerësimin e pikës “v. i) *Deklarimet e pasurive të deputetëve të jenë objekt i kontroleve të plota më të shpeshta*”, GRECO mirëpriti miratimin e ndryshimeve në ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” ku me anë të ligjit nr. 42, datë 6.4.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” në nenin 25/1 u parashikua se: “Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë kryhet: a) çdo 2 vjet për Presidentin e Republikës, **deputetët...**”. GRECO vlerësoi se edhe kjo pjesë e rekomandimit konsiderohet e përmbushur. Përsa i përket pjesës së dytë të rekomandimit, e cila tashmë është konstatuar se zbatohet në mënyrë të kënaqshme në Raportin e Përputhshmërisë, GRECO është i kënaqur të shohë se është vazhduar bashkëpunimi i mëtejshëm ndërinstitucional që përfshin ILDKPKI. GRECO arrin në përfundimin se **rekomandimi v** është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

## 6 TRANSPARENCA INSTITUCIONALE

ILDKPKI, në përmbushje të rekomandimit në Rezolutën e Kuvendit, e cila thekson se Inspektorati i Lartë për vitin 2018 duhet të vijojë “*Vazhdimin e ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimin e mëtejshëm të urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informues ligjorë e publikë, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave privatë*” përgjatë vitit raportues ka trajtuar të gjitha kërkesat e individëve apo mediave, lidhur me publikimin e deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, brenda afatit 10 ditore, pavarësisht fluksit të kërkesave dhe procesit të përpunimit manual për redaktimin e të dhënave personale, duke rritur kështu transparencën institucionale. Në këtë kuadër, për t’u theksuar mbetet fakti se, nuk janë paraqitur kontestime apo ankesa nga palët e interesuara, çka tregon për një punë korrekte dhe serioze të institucionit.

Volumi gjithmonë e më shumë në rritje, tregohet në mënyrë të qartë edhe nga të dhënat e publikimit të deklaratave të interesave privatë, ku ILDKPKI gjatë periudhës 2014 - 2018 ka publikuar rreth **41,261 deklaratata** me kërkesë, ndër të cilat vetëm për vitin 2018 janë publikuar përrreth **10,489 deklaratata**.



## 7 PERFORMANCA FINANCIARE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2018, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, duke paraqitur një realizim të shpenzimeve buxhetore për vitin 2018, si më poshtë vijon:

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të ligjit nr. 109/2017, “Për Buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimit nr. 2, datë 19.1.2018, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” i ndryshuar, i është akorduar një fond buxhetor prej 136,349,100 lekë, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave 102,500,000 lekë (zëri 600);  
Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 13,700,000 lekë (zëri 601);  
Fondi për Shpenzime Operative: 16,760,000 lekë (zëri 602);  
Fondi për Investime: 3,000,000 lekë (zëri 231);  
Transferime korrente: 389,100 lekë (zëri 606).

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 19.1.2018, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në vlerën 133,564,222.18 lekë ose 97.9 %, të fondit të planifikuar për vitin 2018.

ILDKPKI, referuar buxhetit të vitit 2018, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar”.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri i punonjësve u realizua deri në 70 punonjës, nga 70 punonjës të miratuar me Vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 48, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, të ndryshuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 101,255,454 lekë ose 98.8% e fondit të planifikuar, për periudhën respektive, dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 13,532,103 lekë ose 98.8%, e planifikimit për vitin 2018.

Për vitin 2018, janë kryer procedura rekrutimi, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për pozicionet vakante si specialist dhe Ndhimës Inspektor në ILDKPKI.

Për vitin 2018, në realizimin e shpenzimeve buxhetore, Inspektorati i Lartë është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave në harmonizimin e nevojave të ILDKPKI, me burimet financiare në dispozicion, në funksion të përmirësimit të plotë të infrastrukturës institucionale, të rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave privatë dhe me zbatimin e politikave buxhetore, përmes përdorimit ekonomik dhe eficient të burimeve financiare.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontroll në përputhje me legjislacionin përkatës, me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave janë krijuar sisteme kontrolli të brendshme, të cilat janë gjithmonë në përmirësim, duke synuar përbushjen optimale dhe realizimin e objektivave të përcaktuara.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë vitit 2018, në realizimin e shpenzimeve operative, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- ✓ Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare, në funksion të një veprimtarie normale institucionale, të cilat për periudhën e raportuar janë realizuar në masën 100% të fondit të planifikuar vjetor;
- ✓ Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional;
- ✓ Forcimin e mekanizmave investigues për pasuritë e paluajtshme në terren dhe interesave privatë të zyrtarëve brenda dhe jashtë vendit;
- ✓ Rritjes së numrit të hetimeve administrative, të filluara kryesisht nga denoncimet e qytetarëve, shoqërisë civile, medias, biznesit etj;
- ✓ Forcimit të vazhdueshëm të bashkëpunimit të ILDKPKI, me organet e auditimit dhe strukturat e tjera përgjegjëse, për luftën kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik;
- ✓ Zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës teknologjike - informacion.

Gjatë këtij viti, shpenzimet buxhetore të domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara krahas prokurimit me tender, janë realizuar dhe me blerje të vogël, sipas procedurës elektronike dhe janë lidhur kontrata në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në marrëveshjet dypalëshe. Shpenzimet e domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara gjejnë realizim, sipas nevojave konkrete të institucionit.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI për vitin 2018, kanë ardhur kryesisht nga arkëtimi i sanksioneve administrative me gjobë, të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të

detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe ekzekutimit të detyrueshëm nga Zyrat e Përmbarimit, për një vlerë totale prej **29,044,121 lekë**. Këto të ardhura, në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kanë kaluar në Buxhetin e Shtetit, në masën 100%.

ILDKPKI, për vitin e ardhshëm, mbetet i angazhuar në vazhdimin e ndjekjes së një politike menaxhuese efektive, të fondeve buxhetore të akorduara, në drejtim të shpenzimeve të miratuara vjetore, duke mundësuar zbatimin efektiv të objektivave të institucionit, në funksion të një vendimmarrjeje transparente në zbatim të kompetencave të dhëna nga kuadri ligjor në fuqi.

## 8 PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE

Në vijim të punës dhe angazhimit të marrë, lidhur me rritjen e performancës institucionale, gjatë vitit të pestë të ushtrimit të mandatit si Inspektor i Përgjithshëm, më lejoni që në vija të përgjithshme të parashtroj arritjet me theks të veçantë në:

- Marrjen e të gjitha masave institucionale me qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vettingut), duke garantuar procesin e mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të deklaratave të pasurisë për **794 subjekte të rivlerësimit**;
- Vazhdimin e verifikimit të të dhënave të pasqyruara në deklaratat e pasurisë nga subjektet e rivlerësimit, në dokumentet justifikuese e shoqëruese lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë, nëpërmjet kërkimit dhe marrjes së të dhënave nga personat juridikë publikë dhe privatë **për më shumë se 3.000 persona** (subjekte të rivlerësimit dhe persona të lidhur).
- Përfundimin brenda afateve ligjore të proceseve të kontrollit të deklaratave të pasurive të subjekteve të rivlerësimit të përcaktuar në listat e dërguara nga organet e vettingut KPK dhe ONM, në afatet e caktuar prej tyre, konkretisht u përfunduan dhe u dorëzuan pranë këtyre organeve, dokumentacioni i plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për gjyqtarët e gjykatave të apelit, Gjykatës së Apelit Administrativ, Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, si dhe prokurorët e prokurorive të apelit, Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda, ndihmësat dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative, në total **për periudhën janar - dhjetor 2018, 411 subjekte të procesit të rivlerësimit**. Ky numër, së bashku me subjektet e përfshira në listën prioritare, të dërguar pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës nëntor - dhjetor 2017, shkon në total **478 subjekte të procesit të rivlerësimit**;
- Zbatimin me rigorozitet të skemës së kontrollit të plotë, ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, **për 780 subjekte deklaruese**;

- Ndëshkimin e të gjithë shkelësve të kuadrit ligjor, duke aplikuar **112 masa administrative “gjobë”** dhe depozituar **53 referime penale** pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe strukturave të Policisë së Shtetit, duke kërkuar në çdo rast dhe marrjen e masave disiplinore nga institucionet ku zyrtarët shkelës të ligjit, kryejnë funksionet publike;
- Marrjen e të gjitha masave ligjore dhe institucionale, lidhur me zbatimin e ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*. Në këtë kuadër, u zhvilluan në bashkëpunim me OSBE, 12 sesione trajnuese për njësitë përgjegjëse në sektorin privat, gjatë të cilave u arrit të trajnoheshin 226 njësi përgjegjëse pranë këtij sektori. Gjatë vitit raportues, në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit dhe ASPA, u finalizua rishikimi i kurrikulës për organizimin e trajnimit të njësisve përgjegjëse pranë institucioneve publike mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit.
- Marrjen e të gjitha masave ligjore dhe institucionale, lidhur me zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar në drejtim të rritjes së kapaciteteve të Autoriteteve Përgjegjëse. Kështu, gjatë vitit raportues, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit, ekspertët vendas dhe ASPA u finalizua rishikimi i kurrikulës mbi parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe u zhvillua një trajnim trajnerësh, të cilët u angazhuan në zhvillimin e sesioneve trajnuese për Autoritetet Përgjegjëse. Në këtë kuadër, gjatë muajve maj - qershor 2018, si dhe në muajin dhjetor 2018, u zhvilluan trajnimet për autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor, ku 352 pjesëmarrës nga Autoritetet Përgjegjëse morën njohuri lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, të parashikuara nga ligji për parandalimin e konfliktit të interesave;
- Forcimi i marrëdhënieve institucionale me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, ku përgjatë vitit raportues, në bashkëpunim të ngushtë si me ekspertët e projektit të binjakëzimit dhe ekspertët vendas u organizua një Simpozium mbi Konfliktin e Interesit, ku u ftuan të merrnin pjesë të gjithë deputetët. Në vijim, Inspektorati i Lartë me burimet e tij institucionale dhe në bashkëpunim të ngushtë me administratën e Kuvendit, gjatë muajit nëntor 2018, zhvilloi sesion trajnues tre-ditor për deputetët, ku u trajtuan çështje të konfliktit të interesave, identifikimi, trajtimi dhe zgjidhja e tyre, si dhe trajtimi i konfliktit të interesave në kontekstin e zbatimit të Kodit të Sjelljes së Deputetëve;
- Në zbatim të nenit 4/2 dhe nenit 34, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, i cili i hapi rrugën mundësisë së plotësimit dhe dorëzimit të deklaratave në mënyrë elektronike, Inspektorati i Lartë vijoi procesin e ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, i cili do të mundësojë rritjen e efikasitetit në plotësimin, administrimin, kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, si dhe publikimin e të dhënave në deklaratat e interesave privatë për konsultim nga publiku, media, shoqëria civile apo çdo palë tjetër e interesuar. Në këtë kuadër, gjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë bashkëpunoi ngushtësisht me USAID dhe Këshillin e Evropës, duke siguruar zbatimin e detyrimeve kontraktuale lidhur

me zhvillimin e programit të sistemit dhe instalimit/konfigurimit të pajisjeve elektronike të nevojshme për këtë sistem;

- Ndjekjen e një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile, ku të gjitha kërkesat e paraqitura për publikim të deklaratave të interesave privatë, janë trajtuar në përputhje me afatet ligjore, gjë që ka rezultuar në **publikimin e rreth 10,489 deklaratave të interesave privatë, gjatë vitit 2018.**

## 9 PRIORITET PËR VITIN 2019

- Ruajtja dhe forcimi i pavarësisë dhe integritetit institucional, duke qenë kështu garant i paanshmërisë dhe objektivitetit të Inspektoratit të Lartë;
- Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit, duke garantuar vijueshmërinë e zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting) në hartimin dhe dërgimin pranë institucioneve të rivlerësimit dhe ONM, të dokumentacionit të plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara sipas konkluzioneve të kërkuara nga neni 33 i ligjit nr. 84/2016.
- Ndjekja dhe zbatimi i skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin...”*, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave...”*, i ndryshuar;
- Zbatimi dhe monitorimi i ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, në drejtim të forcimit të kapaciteteve të njësisve përgjegjëse pranë organizatave të sektorit publik dhe privat, si dhe ndërgjegjësimi i mëtejshëm i publikut të gjerë mbi këtë mekanizëm raportimi;
- Forcimi i marrëdhënieve bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e formularëve të deklarimit, me qëllim rritjen e eficiencës dhe cilësisë së punës të Inspektoratit të Lartë, duke përfunduar ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit e publikimit të deklaratave të interesave privatë;
- Vazhdimi i ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimi i mëtejshëm i urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informuese ligjore e publike, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave privatë.

**ANEKSI NR. 1**

Në kuadër të zbatimit të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, si dhe Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, për çështjet e përfshira në planin e veprimit, për të cilat është kërkuar raportim në një aneks të veçantë të Raportit Vjetor, Inspektorati i Lartë parashtron sa më poshtë vijon:

**A-Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga ekzekutivi gjatë periudhës së raportimit**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të kuadrit ligjor, ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” ka në kompetencë të tij sanksionimin me anë të masave administrative “gjobë” për shkelje të konstatuara të dispozitave ligjore nga subjektet deklaruese apo njësitë/Autoritetet Përgjegjëse.

Inspektorati i Lartë, për të gjitha masat administrative “gjobë” ka ndjekur rrugët ligjore për të garantuar vënien e tyre në ekzekutim vullnetar ose të detyrueshëm nga ana e subjekteve të sanksionuara.

**B-Pasqyrat financiare, audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm, statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale, plani i veprimit të institucionit, raport ose informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efikasitetit të funksioneve të kapaciteteve njerëzore në funksion të misionit të institucionit****- Audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm**

Në strukturën e ILDKPKI nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Për vitin 2018, ILDKPKI u përfshi në planin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përfundim të të cilit nuk janë konstatuar shkelje lidhur me performancën institucionale.

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 1083/1, datë 17.9.2018, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, plotësimin e pasqyrave financiare në afat, dhënia e opinionit, për saktësinë e paraqitjes së zërave dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit. Nga auditimi i kryer, u konstatua se pasqyrat financiare të ILDKPKI, janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave, si dhe mbështetur në standardet ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200.

Në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të ILDKPKI, ku menaxhimi dhe kontrolli financiar kanë përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin në ILDKPKI, duke arritur objektivat e përcaktuara dhe shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë. Gjithashtu, në zbatim të ligjit *“Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, u vlerësua se, ILDKPKI ka nxjerrë një sërë aktesh në zbatim rigoroz të tij, për menaxhimin e aktiveve.

Gjatë auditimit mbi procedurat e prokurimeve, të realizuara në ILDKPKI përgjatë viteve të audituara në bazë të Programit të Auditimit, grupi i audituesve të KLSH konkludoi se, procedurat ishin realizuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9646 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, dhe VKM nr. 918 datë 29.12.2014 *“Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”*, i ndryshuar.

#### - **Plani i veprimit të institucionit**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, mbështet planin e veprimit të institucionit në zbatim të skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë, përcaktuar nga neni 25/1, i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, duke kryer kontrollet e deklaratave të interesave privatë të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Gjithashtu, në kuadër të reformës në drejtësi, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe fillimit të zbatimit të ligjit nr. 12/2018, datë 5.3.2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, një pjesë e konsiderueshme e kapaciteteve institucionale do të vazhdojnë të jenë të angazhuar në verifikimin dhe hetimin e deklaratave të pasurive të subjekteve të përfshirë në procesin e vlerësimit kalimtar (vettingut) si në rradhët e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe në rradhët e Policisë së Shtetit.

Në objektivat institucionale të Inspektoratit të Lartë, për vitin në vijim, janë përfshirë në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”* forcimi i kapaciteteve të njëjësive përgjegjëse pranë organizatave të sektorit publik dhe privat, si dhe realizimi në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të fushatës ndërgjegjësuere.

## - Pasqyrat financiare

TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI

Llog Ek	Përshkrimi	Plan-Buxheti vjetor 2018 I Rishikuar	Buxheti I realizuar Viti 2018	Realizimi në % Viti 2018
600	Fond Page	102,500.00	101,255,454.00	98.8%
601	Kontrib.Sig Shoq & Shend	13,700.00	13,532,103.00	98.8%
602	Shpenzime operative	16,760.00	15,688,904.18	93.6%
606	Transferta per financime te tjera	389.10	389,100.00	100.0%
231	Investime	3,000.00	2,698,661.00	90.0%
<b>Shuma</b>		<b>136,349.10</b>	<b>133,564,222.18</b>	<b>97.9%</b>

## - Statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, gjatë vitit raportues, ka aplikuar **112 sanksione** administrative me “gjobë”, për mosdeklarim të interesave privatë, konfliktit të interesit, si dhe për shkelje të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Nga këto, janë ankimuar pranë organeve gjyqësore vetëm **44 vendime**, prej të cilave, deri në momentin e raportimit, gjykata ka vendosur në mbështetje të vendimeve të marra nga ILDKPKI për **42 vendime**, duke shfuqizuar vetëm një numër të pakonsiderueshëm vendimesh me sanksion “gjobë”.

Njëkohësisht, Inspektorati i Lartë ka marrë masa nëpërmjet organeve përmbarimore për vënien në ekzekutim të vendimeve lidhur me sanksionet administrative me “gjobë”, ku për vitin raportues rezulton të jenë vënë në ekzekutim **132 vendime**, prej të cilave **60 vendime, i përkasin saksioneve të vendosura përgjatë vitit 2018**. Për t’u theksuar është fakti se pothuajse në gjysmën e rasteve të kërkesave për ekzekutim, për sa i përket vitit raportues, konkretisht në **27 raste**, shlyerja e detyrimit është kryer në mënyrë vullnetare nga subjektet e sanksionuara.

Inspektorati i Lartë, vijon ndjekjen e ekzekutimit të pjesës tjetër të vendimeve pranë organeve përmbarimore, si dhe njëkohësisht ndjekjen e proceseve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ, për çështje të ankimuara.

## - Informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efijencës së rritjes së kapaciteteve njerëzore në funksion të misionit të institucionit

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka përbushur detyrimet që burojnë nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe sipas Kodit të Punës për punonjësit mbështetës. Nëpërmjet Njësisë Përgjegjëse, janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke respektuar parimet kryesore të këtij legjislacioni, si dhe janë kryer vlerësimet e rezultateve në punë të punonjësve dhe procesi i vlerësimit të performancës së tyre në përputhje me afatet ligjore brenda çdo 6 mujori.

Për vitin 2018, janë kryer procedura rekrutimi, në mbështetje të planit vjetor të pranimi në shërbimin civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij për pozicionet vakante për 1 (një) vend për pozicionin në kategorinë ekzekutive dhe 4 (katër) vende vakante Ndhmës Inspektorë në ILDKPKI.

**C- Zbatimi i masave specifike të dala nga rekomandimet e instrumentave ndërkombëtarë, ku Shqipëria është shtet anëtar dhe të raporteve të Komisionit Evropian.**

Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës raportuese, ka vijuar aktivitetin institucional, duke pasur në fokus edhe rekomandimet e drejtuara Republikës së Shqipërisë nga GRECO, në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë që trajton “Parandalimin e korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët”, si dhe në Raportin për Vlerësimin e Përputhshmërisë për Shqipërinë.

Në këtë kuadër, në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të miratuar në Mbledhjen Plenare të 80-të, të mbajtur më 18 - 22 qershor 2018, GRECO vlerësoi si të përmbushur të dy rekomandimet që kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e ILDKPKI.

Konkretisht, në lidhje me Rekomandimin iv.) *Bërja publike e përmbajtjes së deklaratave të pasurive të deputetëve në faqen e internetit në kohën e duhur, duke i kushtuar rëndësi privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe të personave të lidhur me ta, që janë objekt i detyrimit për raportim,*

GRECO mirëpriti punën që po ndërmerret për të përmirësuar deklaratimet e pasurive dhe sistemin e kontrollit, në mënyrë që deklaratat e pasurive të kryhen elektronikisht dhe të përpunohen në mënyrë elektronike, duke siguruar kështu efektivitetin e sistemit të kontrollit dhe duke lejuar që deklaratat e pasurive të publikohen në faqen e internetit të ILDKPKI. Gjithashtu, GRECO, në mbështetje të të dhënave mbi përpunimin dhe publikimin e deklaratave të interesave privatë, kryesisht të deputetëve, vlerësoi se deklaratat e pasurive të deputetëve tashmë janë bërë publike në një faqe zyrtare, duke arritur në përfundimin se **rekomandimi iv** është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Në vlerësimin e pikës “v. i) *Deklarimet e pasurive të deputetëve të jenë objekt i kontrolleve të plota më të shpeshta*”, GRECO mirëpriti miratimin e ndryshimeve në ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” ku me anë të ligjit nr. 42, datë 6.4.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” në nenin 25/1 u parashikua se: “Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë kryhet: a) çdo 2 vjet për Presidentin e Republikës, **deputetët...**”. GRECO vlerësoi se edhe kjo pjesë e rekomandimit konsiderohet e përmbushur. Përsa i përket pjesës së dytë të rekomandimit, e cila tashmë është konstatuar se zbatohet në mënyrë të kënaqshme

në Raportin e Përputhshmërisë, GRECO është i kënaqur të shohë se është vazhduar bashkëpunimi i mëtejshëm ndërinstytucional që përfshin ILDKPKI. GRECO arrin në përfundimin se **rekomandimi v** është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve mbështetëse nga partnerët USAID dhe Këshilli i Evropës/Bashkimi Evropian, për ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, mirëpriti ndryshimet ligjore të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar, të cilat shfuqizuan afatet 3 - 5 vjeçare në drejtim të vënies në funksionim të sistemit elektronik, në përputhje dhe me gjetjet e rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin për Shqipërinë 2018, ku është theksuar se: "*... sipas datave të synuara, vendosur në ndryshimet e fundit ligjore, funksionimi i plotë i sistemit të deklarimit të pasurive online nuk mund të sigurohet para vitit 2022. Kjo duhet të adresohet, në mënyrë që të sigurohet që sistemi të jetë në funksionim brenda një afati kohor më të shkurtër*".

Ju faleminderit !